

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
 AGJENCIA QENDRORE E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2010

SESIONI I

(I DETYRUAR)

VARIANTI B

E martë, 1 qershor 2010

Ora 10.00

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Gjimnazi: Drejtimi shoqëror dhe i përgjithshëm

Udhëzime për nxënësin

Testi është i ndarë në dy pjesë: në poezi dhe në prozë.

Testi në total ka **25 pyetje**.

Në të dy pjesët ka kërkesa me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në kërkesat me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për kërkesat me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

| | | | | | | | | | | | | | | |
|---------|----|-----|-----|-----|-----|----|-----|-----|----|-----|-----|-----|-----|-----|
| Kërkesa | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9a | 9b | 10 | 11a | 11b | 12 |
| Pikët | | | | | | | | | | | | | | |
| Kërkesa | 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | 19a | 19b | 20 | 21a | 21b | 22 | 23a | 23b |
| Pikët | | | | | | | | | | | | | | |
| Kërkesa | 24 | 25a | 25b | 25c | 25d | | | | | | | | | |
| Pikët | | | | | | | | | | | | | | |

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

PJESA I**Ismail Kadare****Pa ty**

Ti ike udhës së pafundme,
ku zverdhin drurët gjetherënës,
mbi gjokse perdesht tani tundet
i arti medaljon i hënës.

Lejlekët ikën. Fill pas teje
si stof i keq u zbeh blerimi,
dhe ngjajnë toka, pylli, reja,
me negativin e një filmi.

Tani në fusha shkoj menduar,
ku nis të fryjë erë e ftohtë,
ku ca mullarë të gjysmuar
duken që larg si donkishotë.

Ç'të bëj, po them me veten time,
në këtë orë të vonë të muzgut,
kur qerrja baltërave bën shkrime,
të lashta si të Gjon Buzukut.

Do shkoj të ulem përmbi pellgjet,
të pi në gjunjë duke rënë,
në grykë e di që do më ngelet
i ftohti medaljon i hënës.

Për pyetjet nga 1 deri në 7 rrethoni alternativën e saktë.

1. Cila nga alternativat e mëposhtme i përgjigjet më mirë temës së kësaj poezie?

1 pikë

- A) Dimri sjell mërzi dhe trishtim.
- B) Ikja e lejlekëve na kujton ngjarje të trishtuara.
- C) Largimi i njeriut të zemrës shkakton emocione të trishta.
- D) Shkrimet e vjetra na ndihmojnë të kuptojmë më mirë veten dhe botën.

2. “Pa ty” është lirikë:

1 pikë

- A) shoqërore
- B) intime
- C) filozofike
- D) peizazhi

3. Kjo poezi është shkruar me varg:

1 pikë

- A) 6 rrokësh
- B) 7 rrokësh
- C) 8 rrokësh
- D) 9 rrokësh

4. Në cilin nga vargjet e mëposhtme është përdorur metaforë? **1 pikë**
- A) Ç' të bëj, po them me veten time
 B) Do shkoj të ulem përmbi pellgjet
 C) Si stof i keq u zbeh blerimi
 D) Tani në fusha shkoj menduar
5. Në vargun: “...me negativin e një filmi...”, autori kërkon: **1 pikë**
- A) të sugjerojë imazhin e një peizazhi bardhezi.
 B) të krijojë idenë e një natyre absurde.
 C) t'i ofrojë lexuesit ndjesinë e ftohtësisë.
 D) t'i japë poezisë një ton trishtues.
6. Dy vargjet e fundit të kësaj poezie sugjerojnë te lexuesi: **1 pikë**
- A) idenë e një dashurie që i kalon përmasat tokësore.
 B) imazhin romantik të një hëne bashkudhëtare të poetit.
 C) një hero lirik që përjeton një dhimbje ekstreme.
 D) një natyrë që mbetet e largët dhe e ftohtë.
7. Në cilën nga alternativat e mëposhtme ka një rend të përmbysur sintaksor? **1 pikë**
- A) Do shkoj të ulem përmbi pellgjet
 B) Lejlekët ikën
 C) Në grykë e di që do më ngelet
 D) Ti ike udhës së pafundme
8. Cila është gjendja shpirtërore që po përjeton heroi lirik? Çfarë e ka shkaktuar atë? **2 pikë**
- _____
- _____
- _____
9. a) Ç' pjesë e ligjëratës është fjala *gjetherënës*? Tregoni si është formuar ajo. **2 pikë**
- _____
- _____
- b) Gjeni në poezi një rast të përdorimit të gjymtyrëve homogjene. **1 pikë**
- _____
10. Me ç' rimë është shkruar kjo poezi? Çfarë i jep poezisë një përdorim i tillë? **2 pikë**
- a) _____
- b) _____

11.

- a) Figura e *hënës* del rëndom e përdorur në letërsi. Në cilin moment të kësaj poezie ajo krijon një imazh romantik? Po imazhin modern?

2 pikë

- b) Si na ofrohet figura e *hënës* përmes këtij imazhi të fundit (modern) dhe ç'ndjesi na sugjeron poeti përmes një përdorimi të tillë?

2 pikë

- 12.** Kjo poezi sjell një atmosferë të veçantë. Tregojeni atë, mbështetur të paktën në dy figura stilistike mbi të cilat është krijuar.

3 pikë

PJESA II**Franc Kafka****Procesi (fragment)**

Pas pak dolën në rrethinat e qytetit, në atë vend, ku nisnin fushat dhe arat. Ishte një gurore e braktisur pranë një shtëpie qytetare. Të dy zotërinjtë ndalën edhe pse ky kishte qenë caku i tyre, por edhe sepse nuk mundnin të vazhdonin dot më tej. U shkëputën nga K., që qëndroi aty i heshtur dhe, pasi i hodhën një vështrim gurores, fshinë me shami djersët e ballit. Vendi rreth e rrotull ndriçohej nga hëna, që shpërndante një dritë të qetë.

Pasi u morën vesh me njëri-tjetrin për mënyrën e kryerjes së detyrës, njëri syresh iu afrua K. dhe i hoqi xhakëtën, jelekun dhe pastaj edhe këmbishën. K. fërgëlloi padashje; me ta vënë re këtë, zotëria, për ta qetësuar, i ra lehtë shpatullave. Pastaj nisi të paloste teshat e veta me aq kujdes, si të ishin gjëra që do t'i hynin në punë, por jo menjëherë. Që K. të mos mërdhinte në atë natë të acartë, e zuri për krahu dhe nisi të ecte me të lart e poshtë; ndërkohë ai tjetri ishte duke kërkuar në gurore një vend sa më të përshtatshëm. Pasi e gjeti, i bëri me shenjë tjetrit, dhe ky e çoi tek ai K. Në faqen e gurores ishte një guvë, prej andej ishte shkëputur një gur, që qëndronte aty pranë, m'u përpara tyre. Zotërinjtë e shtrinë K. për tokë dhe kokën ia vunë mbi gur. Me gjithë përpjekjet e tyre, dhe nënshtrimin e K., pozicioni i zgjedhur nuk ishte as i mirë e as i përshtatshëm. Atëherë njëri iu drejtua tjetrit me lutjen t'ia linte atij ta rregullonte si s'kishte më mirë K., por nuk arriti dot ta bënte. Tekembramja e lanë K. në një pozicion aspak të përshtatshëm. Pastaj njëri prej tyre zbrëtheu xhakëtën dhe nxori një hanxhar kasapi nga këllëfi, që i varej përgjatë jelekut. E ngriti lart thikën e madhe, tehu vezulloi në dritën e hënës. Nisi pastaj një ceremoni e neveritshme, sepse njëri ia zgjati thikën tjetrit sipër kokës së K.; ndërsa ky ia ktheu prapë, duke e kaluar përsëri sipër kokës së K. Atë çast K. tha me vete se mbase i duhej atij vetë ta merrte thikën dhe ta rraste në kraharor. Nuk e bëri, vetëm rrotulloi qafën e lirë dhe këqyri përreth. Nuk mund t'ua lehtësonte mundimin autoriteteve, i mungonte për këtë energjia e nevojshme që këta ia kishin shterur.

Vështrimi i K. u ndal te kati i sipërm i shtëpisë, që ndodhej pranë gurores. Papritur u hapën kapakët e një dritareje dhe shpërtheu drita. U duk një burrë i hollë e i gjatë, që u përkul përpara në parvaz dhe nderi duart përpara. Kush ishte? Ndonjë mik? Ndonjë njeri i mirë? Ndonjë që donte ta mbronte? Një ishte apo ishin disa?

A thua kishte ende mundësi që të shpëtonte? Mos vallë, mund të bëhej gjë? Apo kishte ende fakte, që nuk ishin paraqitur? Me siguri që kishin. Ngjante sikur nuk kishte si luftoje me atë lloj logjike, por ama dëshira për të jetuar ishte shumë e madhe. Ku ndodhet, vallë, ai, gjykatësi më i epërm, të cilin s'e kishte parë kurrë? Ku ishte Gjykata e Lartë, te e cila nuk kishte mundur të arrinte? Ngriti lart duart dhe i hapi shumë gishtat.

Njëri prej dy zotërinjve e zuri K. prej gryke, kurse tjetri ia nguli thikën thellë në zemër dhe e rrotulloi dy herë. Me sytë ku po shuhej drita i pa zotërinjtë, që ishin përkulur mbi të ashtu pranë e pranë për të parë fundin e punës së bërë.

- Si ndonjë qen! – belbëzoi K. dhe iu duk sikur trupi do të mbijetonte edhe pas tij.

Për pyetjet nga 13 deri në 18 rrethoni alternativën e saktë.

13. Ngjarjet e kësaj vepre ndodhin në:

1 pikë

- A) Berlin
- B) Budapest
- C) Bratislavë
- D) Kafka nuk na thotë gjë për këtë.

14. Jozef K. i lind një shpresë në momentin kur:

1 pikë

- A) një nga shoqëruesit i tregon pak ngrohtësi.
- B) shikon pavendosmërinë e shoqëruesve.
- C) shikon një njeri në dritaren e një shtëpie.
- D) shoqëruesit e çojnë pranë një shtëpie qytetare.

15. Në këtë fragment Jozef K. shfaqet:

1 pikë

- A) i kënaqur që gjithçka po merr fund.
- B) i mërzhitur nga zgjedhjet që ka bërë.
- C) i nënshtruar dhe pa energji.
- D) i trembur nga të papriturat.

16. Personazhet në këtë fragment janë:

1 pikë

- A) realë
- B) mitologjikë
- C) historikë
- D) simbolikë

17. Cili nga detajet e mëposhtme e bën këtë skenë të ngjashme me tragjedinë “*Makbeth*” të Shekspirit?

1 pikë

- A) drita e hënës
- B) gurorja e shkretë
- C) koka mbi gur
- D) thika mbi kokën e Jozef K.

18. Në fjalinë “*K. fërgëllloi padashje...*” fjala *fërgëllloi* ka për sinonim:

1 pikë

- A) u drodh
- B) u mpi
- C) u tendos
- D) u shtang

19. Në momentin që Jozef K. pret të ekzekutohet, ai shikon një burrë në një dritare shtëpie.

a) Ç’ nënkupton ky detaj?

1 pikë

b) Si do t’i interpretonit të gjitha pikëpyetjet që i lundin Jozef K. në këtë çast?

1 pikë

20. Në ç'rrethanë zhvillohet ngjarja në paragrafin e parë?
Cili është funksioni artistik i kësaj zgjedhjeje?

2 pikë

a) vendi dhe koha: _____

b) funksioni: _____

21.

a) Në ç'vetë rrëfëhet kjo ngjarje? Sipas mendimit tuaj, pse rrëfimi është në këtë vetë?

2 pikë

b) Në ç'kohë të së shkuarës janë vendosur foljet në këtë fragment?

1 pikë

22. Lexoni me kujdes fragmentin e dhënë. Përqendrohuni në veprimet e tri personazheve dhe shpjegoni si e kuptoni *qetësinë* që i karakterizon ato në një moment kaq të rëndësishëm siç është ekzekutimi.

2 pikë

23.

a) Kjo vepër konsiderohet e veçantë sidomos për ato elemente që nuk zbulohen gjatë rrëfimit. Identifikoni në fragmentin e dhënë dy të tilla.

2 pikë

b) Gjeni shfaqjen e absurdit në këtë skenë dhe shpjegojeni atë.

2 pikë

24. A mendoni se efektin e tragjizmit në paragrafin e fundit e jep një fjalë e vetme (...si qen...), apo i gjithë përshkrimi i skenës së vrasjes? Argumentoni zgjedhjen tuaj.

2 pikë

25. Fondi çnjerëzor i Jozef K. është konsideruar tragjik. Çfarë e bën atë të tillë?
Argumentoni përgjigjen tuaj në formën e një eseje.

8 pikë

| Shtjellimi i idesë (25a) | Organizimi dhe struktura (25b) | Stili dhe origjinaliteti (25c) | Saktësia gjuhësore (sintaksa dhe drejtshkrimi) (25d) | Totali 25 |
|--------------------------------|--------------------------------------|--------------------------------------|--|----------------------------|
| 2 pikë | 2 pikë | 2 pikë | 2 pikë | 8 pikë |
| | | | | |